



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:064796
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05519961

PAKR.nr.25/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra - kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Zyhdi Haziri-anëtarë të kolegjit, me praktikanten gjyqësore Erna Stublla si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Ç. B për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par 1 pika 1.4 dhe 1.5 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), si dhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së palës së dëmtuar M. H, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.255/23 i datës 05.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 06.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e palës së dëmtuar M. H, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.255/23 i datës 05.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për të Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.255/23 të datës 05.12.2023, të akuzuarin Ç. B për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par 1 pika 1.4 dhe 1.5 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, e ka

shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje pesë (5) vite e tre (3) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.03.2023. Ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë pesëqind euro (500 €), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, është udhëzuar i akuzuari që në rast se i njëjti nuk paguan dënimin me gjobë të shqiptuar, ky dënim do të i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur çdo njëzet euro (20 €) të gjobës me një (1) ditë burg.

Është obliguar i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet procedurale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën njëqind euro (100 €), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50.00 €), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me njoftimin e përmbarimit me detyrim.

Pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko- civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

I dëmtuari M. H, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.255/23 të datës 05.12.2023, ashtu që të akuzuarit Ç. B të i shqiptojë dënim më të lartë ose ta anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.39/2024 e datës 25.01.2024 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e palës së dëmtuar M. H, e ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.255/23 i datës 05.12.2023, ashtu që të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje më të lartë se sa me aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën ka marrë pjesë pala e dëmtuar M. H përfaqësuesja e autorizuar e palës së dëmtuar M. H , av. Belkise Berisha- Xhemajli, i akuzuari Ç. B dhe mbrojtësi i të akuzuarit Ç. B, av. Xhevdet Smakiqi, ndërsa Prokurori i Apelit nuk prezantoi në seancë, ndonëse i njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Përfaqësuesja e autorizuar e palës së dëmtuar M. H, av.

Belkise Berisha- Xhemajli në seancën e kolegjit deklaroi se ne qëndrojmë pranë ankesës. Pala e dëmtuar nuk është e kënaqur me lartësinë e dënimit me burgim. Pasojat e të dëmtuarit janë evidente, aktuale dhe shumë të lënda. Ka kërkuar nga Kolegji të merr parasysh pretendimet e palës së dëmtuar dhe rrethanat e tjera, ashtu që të vendosni sipas propozimit në ankesë. I dëmtuari M. H ka deklaruar se pajtohet me avokaten. Mbrojtësi i të akuzuarit Ç. B, av. Xhevdet Smakiqi ka deklaruar se i kundërshton në tërësi pretendimet ankimore të palës së dëmtuar dhe pretendimet e Prokurorisë së Apelit, sepse të njëjtat janë të pabazuara dhe pa mbështetura. Duke konsideruar se Gjykata ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, kur ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë. I ka propozuar Gjykatës që të e hedh si të pa bazuar ankesën e palës së dëmtuar dhe propozimin e Prokurorisë së Apelit. I akuzuari Ç. B deklaron se e mbështet avokatin e tij.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të palës së dëmtuar M. H, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore palës së dëmtuar M. H

I dëmtuari M. H në ankesë thekson, se nuk ka qenë prezent në seancën kur është marrur vendimi në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, për shkak se ka ndodhur një keqkuptim mes tij dhe përfaqësueses së autorizuar. Ai asnjëherë nuk ka kundërshtuar mundësinë për marrëveshje në seancën paraprake, mirëpo konsideron se marrëveshjen nuk e ka parë paraprakisht as ai e as avokatja, si dhe për shkak që i njëjti nuk ka qenë prezent në seancën gjyqësore kur është pranuar marrëveshje dhe është shpallur vendimi pasi që ka qenë në një kontroll mjekësor në atë kohë, të njëjtën marrëveshje nuk do të e kishte pranuar sikur të ishte prezent në seancë, pasi që marrëveshja e tillë përmban një dënim shumë të ulët, duke marrur parasysh peshën e veprës penale dhe atë çfarë të akuzuarit i kanë bërë të njëjtit.

I dëmtuari në ankesë, përshkruan ngjarjen e ditës kritike dhe thekson se si pasojë e veprimeve të akuzuarve, i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, me pasoja të përhershme në shëndet pasi që ka humbur tërësisht shikimin, e si rrjedhojë ka humbur edhe vendimin e punës ku ishte duke punuar si mjeshtër i makinave, madje si pasojë e këtyre lëndimeve i është pamundësuar që të punoj çdo punë tjetër, e asnjë nevojë jetësore pa ndihmën e një personi të tretë dhe tek i njëjti është shkaktuar traumë nga përjetimi i ngjarjes së ditës kritike. Andaj, nga

të lartcekura konsideron se dënimi prej 5 vite e 3 muaj, për të akuzuarin Ç. B, për të është i papranueshëm.

Sipas palës së dëmtuar, Gjykata duhet të marr parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, pasojën e shkaktuar me veprën penale dhe peshën e veprës penale, ashtu që të akuzuarit të i shqiptoj një dënim më të lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 394 par.1 të KPPK-së gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore meqë i akuzuar ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë).

Nga aktgjykimi i ankimuar dhe sipas shkresave të lëndës rezulton se i akuzuari Ç. B është shpallur fajtor, si në dispozitiv I, për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par 1 pika 1.4 dhe 1.5 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje pesë (5) vite e tre (3) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.03.2023, ndërsa për veprën penale, si në dispozitiv II, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë pesëqind euro (500 €), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Nga shkresat e lëndës rezulton se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është arritur me datë 14.11.2023 në prezencë të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Armend Hamiti, të akuzuarit Ç. B e mbrojtësi të tij av.Xhevdet Smakiqi, me të cilën marrëveshje i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par 1 pika 1.4 dhe 1.5 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, si dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe janë pajtuar që të rekomandojnë gjykatës që të pandehurit ti shqiptoj dhe atë për veprën penale vrasje e rëndë në

tentativë nga neni 173 par 1 pika 1.4 dhe 1.5 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK -së dënim me burg prej katër (4) vite deri në pesë (5) vite e gjashtë(6) muaj, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dënimin me gjobë nga 200 euro deri në 500 euro.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rezulton se në seancën e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të datës 05.12.2023, ishin prezent Prokurori i Shtetit Armend Hamiti, i akuzuari Ç. B me mbrojtësin e tij av.Xhevdet Smakiqi, përfaqësuesja e autorizuar të dëmtuarit av.Belkize Berisha, Kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të pretendimeve të Prokurorit të Shteti, mbrojtësit e të akuzuarit, të akuzuarit si dhe përfaqësueses se autorizuar të dëmtuarit av.Belkize Berisha, lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ka konstatuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se ky pranim është bërë në baza vullnetare pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, pranimi i fajësisë mbështete në fakte dhe prova të cilat janë paraqitur në aktakuzë dhe janë pranuar nga vet i akuzuari, po ashtu gjykata ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë nga rrethanat për hedhjen e aktakuzës apo të pushimit të procedurës penale të paraparë në neni 248 par.3 të KPPK-së, dhe se gjykata gjendjen faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, e ka vërtetuar jo vetëm nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari por edhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës andaj, ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të veprave penale të përshkruara si në dispozitiv I dhe II të aktgjykim dhe për këtë ka vendosur të pranoj fajësinë e të akuzuarit dhe ta shpalli fajtor dhe të dënoj në bazë të ligjit. Ndërsa me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë ndaj të akuzuarit Ç. B, të njëjtit për dispozitivin I të akuzës i ka shqiptuar dënimin me burgim prej 5 vite e 3 muaj në të cilën dënim ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, ndërsa për dispozitivin II të akuzës i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 500 euro, ku me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit të parashikuar sipas nenit 69 dhe 70 të KPPK-së, kështu si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e të cilën kryetari i trupit gjykues e ka zbutur dënimin ndaj të akuzuarit ka shqiptuar nën minimumin e posaçëm është fakt se i akuzuari ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë në prokurori, i njëjti ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të tilla apo të ngjashme ndërkaq si rrethana rënduese gjykata morri për bazë shkallën e dashjes, pasi që i pandehuri ka një shkallë të lartë të përgjegjësisë penale, duke shtënë me armë

në drejtim të dëmtuarit dhe duke i shkaktuar lëndime në kokë me pasoja të rënda, me të cilën ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPPK-së.

Në këtë çështje penale ankesës ka paraqitur vetëm i dëmtuari, e cila është refuzuar si e pa bazuar, Gjykata e Apelit rikujton se neni 394 i KPPRK së, parasheh decidivisht, se gjykata vepron dhe shqyrton aktgjykimin në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa, ndërsa çdo herë sipas detyrës zyrtare shqyrton, nëse është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, ku në rastin konkretë kjo Gjykatë konstaton se ligji penal nuk është zbatuar në dëm të akuzuarit, ngase dispozita e nen 230 par.12 përcakton se *“marrëveshja po ashtu mund të përfshij dispozitën ku palët pajtohen për kufijtë e dënimit që do të propozohet nga ana e prokurorit të shteti nëse i pandehuri bashkëpunon thellësisht, ndërsa nëse gjykata shqipton dënim jashtë kufijve në dëm të ndonjërit pale, ajo palë ka të drejt ankese kundër vendimit për dënim”*. E që në rastin konkret, pretendimi i palës së dëmtuar se dënimi i shqiptuar është dënim i ulët në krahasim me peshën e veprës penale dhe pasojën e shkaktuar, si dhe pretendimi se pala po të ishte prezent në seancën e shqyrtimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë, nuk do të pranonte shqiptimin e dënimit të tillë, janë pretendime të pabazuara, pasi që Gjykata e shkallës së parë, ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të propozimit të bërë në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, pra nuk ka tejkaluar kufijtë e përcaktuar me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, si dhe në procesverbalin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka konstatuar prezencën dhe deklarimin e përfaqësueses së palës së dëmtuar av. Belkize Berisha, prezenca e së cilës përmbush prezencën e vet palës së dëmtuar. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kësaj Gjykate janë bazë e mjaftueshme për arsyetimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, se dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.25/24, datë 06.03.2024

Praktikantja gjyqësore

Erna Stublla

Anëtarët e kolegjit

Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar i kolegjit

Beqir Kalludra

Zyhdi Haziri
